



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga vendbanimi Shkup, Komisioni shtetëroro për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e senasëc së 42-të, të mbajtur me datë 11.12.2020, morri:

VENDIM

Procedura për lëndën 12-3968 nga viti 2019, formuar pas denoncimit numër 12-3968/1 me datë 16.08.2019 dorëzuar nga parashtruesi nga vendbanimi Shkup **NDËRPRITET**

Në përputhje e dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për vazhdim të mëtutjeshëm në lëndën 12-3968 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-3968 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-3968 nga viti 2019 është formuar pas denoncimit nr. 12-3968/1 me datë 16.08.2019 si plotësim i denoncimit të vulosur me numrin arkivues 12-129/1 me datë 21.01.2019 dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga vendbanimi Shkup. Në lëndën është bashkangjitur edhe denoncimi me numër 12-2686/1 me datë 13.05.2019, përshkak se bëhet fjalë për denoncim identik, gjegjësisht kopje nga denoncimi 12-129/1 me datë 21.02.2019, i cili vetëmse është dorëzuar deri te KSHPK.

Në denoncimet e dorëzuara janë theksuar akuza kundër personit me vendbanim në Shkup dhe ndërmarrjes SHPK Shkup, përshkak të tregimit të të dhënave të pavërteta dhe të falsifikuara në llogari të shërbimeve komunale dhe me atë ka mundësuar legalizim joligjor të objektit – garazhë të ndërtuar në vitin 1994 dhe marrjen e së drejtës së pronësisë të së njëjtës, si dhe regjistrimin e saj në evidencën e Agjensionit për kadastër të patundshmërive.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Agjensioni për kadastër të patundshmërive në Shkup për të dhëna dhe informacione në lidhje me rastin e lëndës. Në kërkesë të KSHPK është dorëzuar informimi i kërkuar dhe pas rishikimi të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për dyshime në procedurën e legalizimit të objekti, i cili sipas akuzave të parashtruesit, fillimisht ka qenë blerë nga babai i tij si tendë dhe pastaj është rindërtuar në vitin

1994 si garazhë të cilën ai e ka përdorur për 25 vite. Për këtë shitblerje parashtruesi i denoncimit thekson se ka pas marrveshje dhe se pagesa për të njëjtën në vlerë prej 500 markave gjermane e ka bërë dorë në dorë me pronarin paraparak dhe për dëshmitar për atë përmend komshiun e tij

Parashtruesi i kërkesës, me datë 11.12.2014 dorëzoi kërkesë për legalizim të objektit të përmendur, për të cilën procedura është shtyrë deri në vitin 2018, kur edhe ka dorëzuar përsëri kërkesë për legalizim me datë 19.12.2018, kur edhe do të kupton se objekti i lëndës veçmë është legalizuar në vitin 2016, nga ana e personit me vendbanin dhe në procedurën e legalizimit, sipas parashtruesit personit të përmendur i ka ndihmuar nga ana e ndërmarrjes ”.....” SHPK Shkup e cila ia ka përgaditur elaboratin e nevojshëm gjeodezik, i cili sipas parashtruesit ka qenë përgaditur në bazë të falsifikimit të dokumenteve dhe faturave për shërbime komunale. Parashtruesi thekson se me datë 20.12.2018 nga ana e vet është dorëzuar kërkesë deri tek Komuna e me të cilën kërkon shfuqizim të vendimit për legalizim të dhënë personit të përmendur, dhe gjithashtu se është drejtuar edhe deri tek kontrolli i brendshëm i Agjencionit për kadastrë të patundshmërive në lidhje me legalizimin joligjor të objektit i cili është i evidentuar me Fletëpronësi nr. KK

Në plotësimin e denoncimit janë shtuar akuza edhe për veprime tjera joligjore të bëra nga ana e Kryeprefektit paraparak të Komunës dhe personit të punësuar në Komunë, në lidhje me material të vjedhur ndërtimor të komunës dhe përdorur për ndërtim të objekteve të veta dhe kërkon nga KSHPK t'i kontrollon akuzat e lëndës dhe të ngritë procedurë përkatëse.

Me datë 11.03.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Agjensioni i kadastrës për patundshmëri në Shkup dhe dorëzuar Vërtetime për rishikimin më hershme të regjistrimeve të bëra për PK/..... dhe PK/..... të regjistruar në Fletpronësi numër për KK gjatë kontrollimit të bërë në të njëjtat është konstatuar se në vitin 2016 në bazë të vërtetimit nga AKP dhe Vendimit për legalizim të objektit të ndërtuar pa leje me datë 21.10.2015 dhe nga 22.02.2016 nga Komuna e, në Fletpronësinë e përmendur është regjistruar pronë, (banesë numër 1 përdhese të objektit hyrja 1 me sipërfaqe prej 64 metra katrorë dhe sipërfaqe ndihmëse prej 20 metra katrorë dhe hapsirë afariste numër 1 prej 102 metra katrorë, në objektin 2 hyrja 1 në përdhese dhe hapsirë afariste prej 29 metra katrorë në objektin 1 hyrja 1 në përdhese – të regjistruar me datë 22.06.2016), në pronësi të persnit, me të drejtë prone.

Me datë 19.11.2020 (në ora 11:45) nga ana e KSHPK është bërë kontakt me parashtruesin e denoncimit dhe në bisedë telefonike i është kërkuar informacione për atë se vallë nga ana e tij janë udhëhequr procedura për rastin e lëndës para organeve tjera kompetente dhe ka marrë përgjigje për kërkesat me datë 20.12.2018 i cili i ka dorëzuar deri tek Komuna dhe AKP. Nga ana e parashtruesit është informuar kjo:

- Në ditën e dorëzimit të denoncimit deri tek KSHPK nga ana e tij është dorëzuar edhe denoncim në PTHP Shkup me bazë për dyshime për falsifikim të faturave, dhe për të njëjtën ende nuk ka marrë informimin për veprimin e tyre kompetent.
- Në lidhje me kërkesën me datë 20.12.2018, dorëzuar në periudhën 2018-2019 dhe atë: nga ana e Komunës është vepruar për kërkesën e parashtruesit dhe vendimin e lëndës për legalizim është shfuqizuar dhe objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme, me çka nga ana e personit është dorëzuar ankesë deri tek komisioni i shkalës së dytë pran Ministrisë së transportit dhe lidhjes e cila ia ka pranuar ankesën dhe objekti është kthyer në pronësi të veten, nga ana e kontrollit të brendshëm në AKP gjithashtu kanë vepruar për kërkesën e parashtruesit dhe ai ka qenë informuar se nga ana e tyre është bërë

kontroll në vend ngjarje me çka objektin iu ka treguar dhe hapur ndonjë person tjetër kurse parashtuesi është udhëzuar të drejtat e veta për rastin t'i kërkon në procedurë gjyqësore.

- Për këtë rast është drejtuar vetëm deri tek KSHPK dhe tek PTHP dhe nuk është drejtuar tek organet tjera në shtet dhe nuk ka bërë procedurë gjyqësore.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, KSHPK konstaton se për rastin e lëndës është vepruar nga ana e organeve tjera kompetene – Komuan dhe AKP, dhe njëherit për problemin konkret nga ana e parashtuesit është dorëzuar denoncim deri në organ tjetër kompetent – PTHP - Shkup pran të cilës procedura është në vazhdim. Duke pasë parasyshë të konstatuarës, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të tij të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi me dispozitën e këtij vendimi.

Është vendosur me datë 11. Dhjetor 2020 me nr. 12-1212/3

Dorëzuar deri tek: Arkiva; parashtuesi
Pas mbarimit të KSHPK
Punoi: J.C., këshilltarë
Miratoi: m-r Sh.S., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЉР
PARANDALIM TË
KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**